

Një 3-vjeçar anglez është shtruar në spital… si i alkoolizuar. Vogëlushi, i cili është “pijaneci” më i vogël në Botë, ka marrë pije alkoolike për gjashtë muaj me radhë dhe vuante nga dridhje trupi të papritura e ndryshime të shpeshta humori.

Një ekspert u shpreh për mediat britanike: “Të diagnostikohesh si i alkoolizuar do të thotë se ky fëmijë ishte i varur nga pija. Prindërit e kanë bërë që të pijë shumë alkool dhe kjo është një gjë e tmerrshme”

Muajin e kaluar, një vajzë 8-vjeçare skoceze, u bë e njohur si personi i alkoolizuar më i ri në botë./TCH/

Phoca PDF